

*Data: 09.07.2010*

*PORTI I DURRËSIT, MBI 1.6 MILION TON MALLRA NË 6 MUAJ*

---

-Eksportet rriten me 238 përqind-

Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti në portin detar të Durrësit janë përpunuar 1.605.991 ton mallra gjithsej, ose 7 përqind më shumë se e njejta periudhë e vitit të kaluar.

Sipas statistikave eskportet me anije tregtare dhe me tragete janë rritur me 238 përqind, duke arritur në 599.645 ton mallra.

Anijet tregtare kanë transportuar 463.500 ton mallra eksporti, ndërsa tragetet 136.145 ton mallra të tjera me trajlera dhe me kamjonë.

Në 6 muajt e parë të këtij viti janë eksportuar: 46.920 ton krom rifuxho; 52.951 ton klinker; 21.030 ton pllaka gipsi; 28.950 ton çimento; 66.205 ton llamarina; etj.

212.842 ton mallra eksporti janë transportuar me kontejnerë.

Gjatë kësaj periudhe janë importuar 1.006.346 ton mallra, ose 80 përqind e sasisë së përpunuar në të njejtën periudhë të vitit 2009.

Numri i përgjithshëm i kontejnerëve të përpunuar gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2010 ka arritur në 35.121 ose 4.865 më shume.

Kontejnerët kanë transportuar 464 mijë ton mallra gjithsej, ose 143 mijë ton më shumë se sa në 6-mujorin e parë të vitit 2009.

17.789 kontejnerë janë përpunuar në dalje nga porti i Durrësit, ndërsa 17.332 të tjerë në hyrje.

